

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës së 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 16 në relacion me Nenin 10 dhe të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/35 (“Rregullorja e Pensionit”) në lidhje me investimet e duhura dhe me vend të mjeteve të pensioneve të Fondeve të Pensionit dhe, aty ku aplikohen Siguruesit e Pensionit.

Bordi Drejtues I Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e mbajtur më 25 korrik 2002 përshtat si vijon:

Rregulla 9 mbi Investimet e Mjeteve të Pensioneve

Neni 1 Sfera dhe qëllimi I rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo rregull I adresohet investimeve të mjeteve të pensioneve të Fondit Suplementar Pundhënës të Pensionit (“Fondi I Pensionit”) dhe, aty ku aplikohet, për Pensionet Suplementare Individuale (“Siguruesi I Pensionit”).

1.2 Qëllimi I Rregullës

Kjo Rregull parashkruan disa udhëzime të caktuara për investim me vend dhe si duhet të mjeteve të pensioneve sipas dispozitave të Nenit 16 në relacion me Nenin 10 të Rregullores së Pensionit.

2.1 Definimi

Të gjitha kushtet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe shpallur në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq definojnë më tutje në këtë Rregull.

“Menagjeri I Mjeteve” është entiteti I definuar sipas Nenit 1 të Rregullores së Pensionit që zhvillon punën e menagjmentit të mjeteve në pajtim me ligjet e aplikueshme, rregulloret dhe rregullat e njohura në Kosovë.

“Bordi I Drejtorëve” nënkupton trupin më të lartë drejtues të entitetit të pensionit që përbëhet prej antarëve të bordit të atij trupi drejtues.

“Produkti I fituar ose I prejardhur” është pasuri financiare ose detyrim vlera e të cilit varet nga (ose vjen nga) pasurit e tjera ose detyrimet (pasurit themelore). Derivatet janë produkte financiare që përfshijnë një asortiment të gjerë të instrumenteve, të tilla si avancimet, pritjet, caktimet dhe thirrjet, garantimet, shkëmbimet ose përzierjet. Në këtë Rregull, qdo investim që është I strukturuar që të rezultoj karakteristikat e produkteve derivate konsiderohet si produkt derivat.

“Principet e Investimit” që I referohen politikës investuese dhe objektivave të zhvillimit të investimeve të përshtatura nga entiteti I pensionit për investimet e mjeteve të pensioneve qoftë të shprehura në Urdhëresat e Pensionit, Rregullat e Pensionit ose në direktivat e investimit.

“Direktivat e Investimit” I referohen urdhërave apo udhëzimeve të bëra nga entiteti I pensionit për menagjerin(et) e mjeteve duke specifikuar kushtet, dhe termet dhe mënyrën e investimit të mjeteve të pensioneve.

“Entitetet “Open-end”” I referohen entiteteve të organizuara dhe që operojn si kompani të investimeve të pastra dhe janë të autorizuar që të lëshojnë numër të pakufizuar të aksioneve të barabarta (në njësitë e tëra apo të ndara) që përfaqsojnë pronsin e ekuiteteve në entitete të tilla në favor të aksionarve (investitorëve). Ky term përfshin fondet e ndërsjella, unitrustet dhe entitetet tjera të ngjajshme të investimeve të pastra.

“OECD” I referohet Organizatës për Bashkpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

“Entiteti I Pensionit” I referohet Fondit të Pensionit dhe aty ku aplikohet, Siguruesit të Pensionit.

“Palët e parashkruara”, në lidhje me entitetet e pensionit, përfshin vet entitetin dhe ndonjë si vijon:

- a) Antarët e trupit drejtues të tij ose të bordit.
- b) Kujdestari që mban një pjesë ose të gjithë pasurit e pensioneve të trusteeve, ose
- c) Menagjeri I mjeteve që investon ndonjë ose një pjesë të mjeteve të pensioneve.
- d) Ndonjë person apo individ që është një entitet I bashkuar në relacion me nenin a), b) dhe c) më lartë.

“Fondet” përfshijnë portofoliot e ekuiteteve, investimet në marrveshje, borxhet ose obligimet tjera dhe të gjitha llojet tjera të investimeve (të pranueshme).

Neni 3

Kushtet në investimet e mjeteve të pensioneve

3.1 Kushtet e përgjithshme

Investimet e mjeteve të pensioneve, sipas kushteve specifike të parashkruara në Nenin 3.2 të kësaj Rregulle, duhet të përshtatet me kushtet e përgjithshme si vijojnë:

- a) Natyra e mjeteve dhe investimeve. Entitetet e pensionit duhet të investojnë pasurit e tyre vetëm në klasët e investimeve të lejuara (të pranueshme) të parashkruara sipas kësaj Rregulle ose në kesh të deponuara te Kujdestari ose për shumat që janë arsyeshëm të nevojshme për të zhvilluar operimet e tij të pensionit.
- b) Determinimi I pranueshmëris. Pranimi I investimit është i determinuar në kohën e bërjes ose përvetsimit. Nëse determinimi I pranueshmëris është I bazuar në shumën, kufizimi është bazuar në shumën e totalit të investimeve të mjeteve prej datë se fundit të vlersimit, që është raportuar në BPK.
- c) Principet e investimit dhe direktivat. Investimet e mjeteve të pensioneve duhet të jenë në pajtim me deklaratën e principeve të investimit dhe konform me direktivat e investimit të përshtatura dhe të lëshuara nga entiteti I pensionit në pajtim me kërkesat e rregullores së Pensionit dhe këtë Rregull.
- d) Sanimi I shkeljes dhe thyerjes. Investimet e bëra duke thyer dhe shkelur principet dhe direktivat e investimit duhet të përmirsohen menjëherë. Thyerjet dhe devijimet, të investimeve të mëparshme të konfirmuara vijnë si shkak ose shkaktohen pas kontrollit të bordit të drejtorëve ose menagjerit të mjeteve të entitetit të pensionit mund të përmirsohen ose korrigjohen brenda një kohe të tillë dhe mënyre që është sa më pak e dëmshme për interesin e pjesmarrësve e cila periodë kohore nuk është më e gjatë se sa 6 muaj prej datës së asaj thyerje apo devijimi.
- e) Qështjet e përshtatjes. Trupat drejtues të entiteteve të pensionit që sigurojnë pensionet duhet të dorzoj në BPK së bashku me raportet tremujore dhe vjetore, ekstraktin e vërtetuar nga një zyrtar (officer) I autorizuar , duke vërtetuar se të gjitha pasurit e investuara janë në përputhshmëri me kushtet, kufizimet, dhe restriksionet të parashkruara në Rregulloren e Pensionit dhe në këtë Rregull dhe në konformitet me deklaratën e principeve të investimit dhe direktivat e investimit të adaptuara nga entiteti; e siguruar, nëse ndryshe, ekstrakti I vërtetuar duhet qartë të tregoj natyrën e shkeljes, thyerjes ose devijimit, duke identifikuar pasurit e investuara të veqanta të pa-përshtatura dhe duke përshkruar mënyrën dhe afatin kohor për përmirsim dhe/ose korrigjim.

3.2 Kushtet specifike

- a) Rregullat e shpërndarjes. Në qdo kohë investimet e mjeteve të pensioneve janë temë e kushteve specifike që vijnë:
- (i) Aksionet ose aksionet e kapitalit nuk duhet të jenë më të larta se 5% se totali I aksioneve të lëshuara nga një emitues.
 - (ii) Obligacionet nuk duhet të jenë më të larta se 30% se një emitim I vetëm I obligacionit.
 - (iii) Investimet totale në qdo entitet, duke përfshirë edhe entitetet e tij të bashkuar, nuk duhet të jetë më I lartë se 5% të pensionit total.
- b) Kërkesat për vlersim. Për mbrojtje të mëtutjeshme të kualitetit të mjeteve të pensionit, BPK-ja koh pas kohe mund të përshkruaj shkallët minimale të investimit ose klasifikimi I fondeve në determinimin e pranueshmëris së investimit. Shkalla e investimit ose kushtet e klasifikimit duhet të jenë formojnë një pjesë apo pako të kësaj Rregulle në datën e rregulluar me direktivat me shkrim të BPK që përshkruajn kërkesën(at) e tillë.

Neni 4

Investimet e pranueshme (të lejuara)

4.1 Fondet e lëshuara dhe/ose të lokalizuara jashtë Kosovës

Pasurit e pensioneve mund të investohen vetëm në llojet ndërkombtare dhe klasat si vijojnë:

- a) Fondet monetare, duke përfshirë llogarit bankare dhe deponimet në banka që janë licensuar nga autoriteti rregullues I bankës I shteteve antare të OECD-s, dhe licensa e të cilit mbetet në fuqi dhe në gjendje të mirë.
- b) Fondet e lëshuara nga qdo shtet antar I OECD-s.
- c) Fondet e lëshuara nga qeveritë lokale në shtetet antare të OECD-s në zgjerimin e garantive nga shteti përkatës.
- d) Fondet e regjistruara me rregulatorin e kapitalit të tregut të ndonjë shteti antar të OECD-s dhe të vendosura për ofertë publike dhe aktivisht të regjistruara ose të shitura në Bursën e Aksioneve që në shtetet e tilla është rregulluar dhe mbikqyrur në mënyrë përkatëse.
- f) Fondet e ndërsjella dhe fondet tjera të investimeve (Open-end entities) në lidhje me aprovimin e shteteve antare të OECD-s për themelimin e tyre dhe për përshtatshmërinë e të cilave kërkesat janë parashkruar nga autoriteti përkatës

rregullator dhe mbikqyrës brenda shteteve të tilla antare në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të biznesit të entiteteve të tilla “open-end”.

- g) Të gjitha llojet dhe klasët tjera të fondeve internacionale që mund të autorizohen, koh pas kohe, nga ligjet efektive, statutet, rregulloret dhe rregullat e lëshuara nga autoritetet kompetente në Kosovë.

4.2 Fondet e lëshuara dhe/ose të lokalizuara Brenda në Kosovë

- a) Fondet monetare, duke përfshirë llogarit bankare dhe deponimet në banka që janë të licensuara nga BPK dhe që zhvillojnë biznes bankar në Kosovë në raport të mirë me kërkesat rregullore të BPK-s.
- b) Fondet e lëshuara nga autoritetet kompetente në Kosovë, me garantim të zgjatur nga autoritetet e tilla.
- c) Fondet e lëshuara nga ndërmarrjet publike dhe/ose private që janë regjistruar me rregullatorin e tregjeve kapitale në Kosovë duke siguruar se fondet e tilla janë regjistruar dhe tregtuar në bursën(at) e fondeve të licensuara në Kosovë ose në shtetet antare të OECD-s dhe në lidhje me rregullimin dhe mbikqyrjen e autoritetit të kapitalit të aplikuar të tregut në shtetet e tilla.
- d) Fondet e ndërsjella dhe fondet tjera të ndërsjella (“open-end entities”) sipas aprovimit në Kosovë dhe për përshtatshmërinë e tillë kërkesat janë parashkruar nga autoriteti rregulator përkats ose mbikqyrës në Kosovë në lidhje me zhvillimin e aktivitetit të biznesit të entitetit të tillë “open-end”.
- e) Të gjitha llojet tjera dhe klasët e fondeve vendase që mund të autorizohen koh pas kohe, nga ligjet ne fuqi, statutet, rregulloret dhe rregullat e lëshuara nga autoritetet kompetente në Kosovë.

Neni 5 Investimet e ndaluara

5.1 Investimet e ndaluara

Pasurit e pensioneve nuk mund të investohen në llojet apo klasët e investimeve si vijojnë:

- a) Fondet që janë ose të paregjistruara ose të patregtuara publikisht.
- b) Pasurit që nuk mundën legalisht të barten, shiten, dispozohen ose në mënyrë tjetër të tjetërsohen.
- c) Fondet derivate, opcionet, të ardhshmet, të përparshmet dhe marrveshjet tjera në lidhje me fondet dhe pasurit tjera financiare.

- d) Pasurit materiale dhe të patundshme të pa regjistruara në tregjet e organizuara dhe për të cilat vlersimi është I pacaktuar duke përfshirë por duke mos qenë i kufizuar për objektet me vlerë, punimet e artit, antik, koleksione, dhe automjete.
- e) Fondet e lëshuara nga palët e përshkruara siq janë definuar në këtë Rregull.
- f) Fondet që sipas llojit dhe klasës nuk janë të lejuara me Rregullore, këtë Rregull dhe/ose fondet e siguruara që sjanë në pajtim me principet e investimit dhe direktivat e entitetit të pensionit në kohën e përvetsimit të tyre.
- g) Pasurit dhe fondet e tjera të tilla siq janë specifikuar nga SRSB dhe /ose ligjet, statutet, rregulloret dhe rregullat e nxjerrura nga autoritetet kompetente.

Neni 6 Dispozitat tranzitore

6.1 Shpërndarja e investimeve

Në mënyrë që të sigurohet tranzicion I lehtë për rregullat e shpërndarjes të parashkruara sipas Nenit 10.5 dhe 10.6 të Rregullores dhe Nenit 3.2 të kësaj Rregulle shuma e mjeteve bëhet e mjaftueshme që të shpërndaj me efikasitet. Fondi I Pensionit dhe Siguruesit e Pensionit do të kërkohen që të përshtaten me rregullat e shpërndarjes së investimeve nëse kushtet si vijojnë janë plotsuar:

- a) Investimet e bëra janë në pajtim me termet dhe marrveshjet që gjenden në Deklaratat e tyre të Principeve të Investimit të aprovuara në BPK.
- b) Pasurit e Fondit të Pensionit, ose aty ku aplikohet Siguruesit të Pensionit janë ruajtur nga Kujdestari I pavarur në pajtim me marrveshjen e kujdestarisë së mjeteve në konformitet me kërkesat e Rregullës 8 të këtyre Rregullave.
- c) Pasuritë janë investuar vetëm në klasët e mjeteve të rregulluara më herët në këtë rregull dhe në Rregulloren e Pensionit dhe nuk ka investime në kategoritë e ndaluara të investimeve sipas kësaj rregulle dhe Rregullores së Pensionit.
- d) Shuma e mjeteve nuk tejkalon XXX Euro.
- e) Fondi I Pensionit ose Siguruesi I Pensionit ka prezentuar në BPK një plan të pranueshëm për ngritjen e shpërndarjes së investimeve të tij.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo rregull do të hyj në fuqi më 25 korrik 2002.

Drejtori i Përgjithshëm